



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2 Nr.18 Tiranë,

Tel. 04 2268142; Fax 04 2268141

Nr. 293 Prot.

Tiranë, më 01.04.2016

V E N D I M

Nr. 33, datë 01/04/2016

"Për përfundimin e procesit të mbikëqyrjes në lidhje administrimin e shërbimit civil në Agjencinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, neneve 80-104, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe nenit 34 të Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të Relacionit të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë "*Mbi verifikimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 45, datë 29.04.2015, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike"*, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil", në lidhje me procesin e mbikëqyrjes të administrimit të shërbimit civil të realizuar në Agjencinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike,

Vërej se:

Në zbatim të Vendimit nr. 11, datë 10.02.2015, "*Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në Agjencinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike*" të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është realizuar inspektimi në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil pranë këtij institucioni.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 45, datë 29.04.2015, "*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike*", në të cilin është vendosur:

1. Miratimi i raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, pjesë e këtij vendimi.

2. Të përfundojë verifikimi i gjendjes gjyqësore për nëpunësit që janë pjesë e shërbimit civil dhe të materializohet procesi në dosjen e personelit.
3. Të plotësohen dosjet e personelit në rastet e konstatuara me mungesa në ankesraportet, pjesë e këtij vendimi.
4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 30 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim.

Me kalimin e afatit procedural prej 30 ditësh, Komisioneri me Vendimin nr. 27, datë 21.03.2016, vendosi të ndërmarrë procesin e verifikimit të zbatimit të vendimit, procedurë e bazuar në nenin 14, të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe në Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit.

Në përfundim të verifikimit, u konstatua se njësia përgjegjëse ka zbatuar rekomandimet e dhëna në Vendimin nr. 45, datë 29.04.2015, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike”. Konkretisht rezulton se:

- ✓ Në lidhje me pikën 2 të Vendimit nr. 45, datë 29.04.2015, njësia përgjegjëse ka përfunduar procesin e verifikimit të gjendjes gjyqësore për nëpunësit pjesë e shërbimit civil, duke materializuar procesin në fjalë nëpërmjet administrimit në dosjet përkatëse të personelit të vërtetimeve të gjendjes gjyqësore.
- ✓ Në lidhje me pikën 3 të Vendimit nr. 45, datë 29.04.2015, njësia përgjegjëse ka ndërmarrë dhe plotësuar dosjet e personelit në rastet e konstatuara me mungesa në aneksraportet, pjesë e vendimit të sipërpërmendur, duke administruar në to vërtetimet e gjendjes gjyqësore, si dhe raportet mjekoligjore të rifreskuar për vitin 2016 mbi gjendjen shëndetësore të nëpunësve përkatës.

Sa më sipër, u konstatua se reagimi i njësisë përgjegjëse për zbatimin e Vendimit nr. 45, datë 29.04.2015 ka qenë në përputhje me rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes dhe në përfundim arrij në konkluzionin se Vendimi nr. 45, datë 29.04.2015, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike”, është zbatuar plotësisht, nga ana e subjektit të mbikëqyrur, **Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike.**

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në nenin 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e procesit të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në institucionin, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit nr. 45, datë 29.04.2015, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike”*.
3. Për këtë vendim të njoftohet Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut pranë Kuvendit të Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA